



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
POLICIA BASHKIAKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2019

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Subjektit “_____” sh.p.k, Tiranë

e.mail: _____

Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike me datë 27.03.2019, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion mbi dokumentacionin e plotë mbi një gjobë vendosur subjektit “_____” sh.p.k, nga Policia Bashkiake Shkodër, ju bëjmë me dije se:

Për çdo kundravajtje që konsiston në transportin rrugor, Bashkia Shkodër kërkon informacion nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, duke kërkuar indentifikimin e personave që i posedojnë këto automjete si dhe targën e tyre. Me shkresën nr.3520 prot, datë 06.03.2018, Policia Bashkiake i ka kërkuar informacion DRSHTRR-Shkodër. Me shkresën me nr.1170 prot, datë 23.03.2018, DRSHTRR-Shkodër, ka informuar Bashkinë Shkodër se shkresë automjeti me targë _____, tipi Volvo, me kapacitet për transport malli është në pronësi të subjektit _____. Bazuar në informacionin e dërguar është bërë dhe regjistrimi i gjobës në sistemin e taksave të Bashkisë Shkodër.

Bashkëngjitur do të keni procesverbalin e konstatimit të shkeljes, kërkesen për informacion drejtuar DRSHTRR-Shkodër dhe shkresa kthim përgjigje nga DRSHTRR-Shkodër.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë.

KRYETAR

Voltana ADEMI